



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 17
28.12.2011

NR. VENDIMI 15
29.12.2011

VENDIM
“Në emër të Republikës”

Gjykata e Shkallës së Parë
për Krime të Rënda Tirane e përbërë prej:

Gjyqtare : Iliriana OLLDASHI

Asistuar nga sekretari gjyqësor **Besjan Hysi**, sot në datën **29/12/2011**, ora **10.00 në Tiranë**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën penale nr. **17** që i përket :

Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga prokurori **A. Xh.**

Me objekt: Sekuestrimin e pasurive.

KUNDËR:

1.S. (S.) K., i biri i M.
dhe N., i datëlindjes xx.xx.xxxx, banues në
Xxxxx, Rruga « xxxx xxxx », Pallati xx/xx.
(Aktualisht është duke vuajtur dënimin pranë
xxxx xxxxx xxxxx).

PERSONA TË TRETË:

1.N. (N.) A, e bija e
M.-it, dhe e B., e datëlindjes xx.xx.xxxx,
banuese në xxxxx, Rruga « xxxx xxxx »,
Pallati xx/xx. (xxxx x xxxxx xxxx).

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 10192 datë 03/12/2009 “Për
Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të

Organizuar dhe Trafikimit NËpërmjet
Masave Parandaluese kundër Pasurisë”.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës të zhvilluar në prani të prokurorit A. Xh. që kërkoi: pranimin e kërkesës, kjo gjykatë pasi dëgjoi kërkimet dhe shqyrtoi aktet e paraqitura :

VËREN se :

Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë ka paraqitur para kësaj gjykate një kërkesë për sekuestrimin e pasurive të shtetasit S. K dhe personit të tretë N. (N) A, nëna e shtetasit S. duke pretenduar se janë subjekte të hetimit pasuror sipas ligjit **nr.10192 datë 03.12.2009** “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit NËpërmjet Masave Parandaluese Kundër Pasurisë” dhe pasuritë e zoteruara nuk i përgjigjen nivelit të të ardhurave dhe fitimeve të tyre, si dhe ekziston rreziku, që këto pasuri të humbasin, apo tjetërsohen. Kërkesën prokurori e paraqet duke ju këtyre fakteve:

“Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë më datë 29/09/2009, ka regjistruar procedimin penal Nr.66, për veprat penale të parashikuara nga nenet 134, 139, 333/a dhe 334 të K.Penal, në ngarkim të të pandehurve **S. K,..**etj.

Nga hetimet e kryera, ka rezultuar e provuar se : Të pandehurit **S. K , A. B , S . B , E. (F) L. , D. D** , janë banorë të xxxxx shokë midis tyre. Këto shtetas kanë vepruar në kuadër të një grupi të strukturuar kriminal me qëllim vjedhjen e pasurive të shtetasve dhe bizneseve. Të qëndrueshëm në veprimtarinë e tyre kriminale kanë qënë shtetasit **S. B , E. (F) L. e S. K** të cilët kanë përfshirë në veprimtarinë e tyre kriminale herë shtetasin **A. B** e herë shtetasit **D. D** , ndërsa të pandehurit **T. M , E.H** e **D. M** kanë bashkëpunuar midis tyre dhe me pjesëtarë të grupit kriminal për të kryer veprën penale të vjedhjes në kuadër të bashkëpunimit të thjeshtë.

Konkretisht;

-Më datë **xx.xx.xxxx**, të pandehurit **S. K , E . L , S. B** dhe **A. B** në bashkëpunim mes tyre kanë vjedhur një xxxxxxxx me përmasa **xx x xx** në të cilën ka qënë një shumë prej **600 000** lekësh në ambjentet e pikës së lojrave të fatit “xxxxx”që ndodhet në bulevardin “xxxxx xxxx”, përballë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxxx.

- Me datë **22.02.2009** të pandehurit *S. K , E. L , S. B* dhe *A. B* në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë hyrë duke thyer derën e objektit në ambjentet e shoqërisë “A. T. H. S.”, sh.p.k. në rrugën “xxxx xxx xxxx” në Xxxxx, ku dhe kanë vjedhur kasafortën brenda të cilës **ishin 33. 600 Euro, 2920 USD dhe 39 000 lekë.**

- Me datën **28.04.2009** të pandehurit *S. K , E. L , S. B* dhe *A. B* kanë hyrë në banesën e shtetasit *I. Ç* që ndodhet në rrugën “xxxxx xxxxxx”, në xxxxx duke prerë me oksigjen derën e banesë së një kati më poshte dhe nëpërmjet saj kanë hyrë në banesë e kanë vjedhur nga banesa një kasafortë brenda të cilës ndodheshin **340 000 Euro, 13 400 000 lekë dhe 5000 Paund.**

- Në datë **22.10.2009** rreth orës 02, të pandehurit *S. K , E. L , S. B dhe D. D* në bashkëpunim në mes tyre kanë tentuar për të vjedhur banesën e shtetasit *D. P* që ndodhet në Lagjen “xxx xxxx” në Tiranë. Ata janë futur brenda në banesë, në katin përdhes të saj duke u ngjitur nëpërmjet kangjellave dhe thyer një prej xhamave të derës duralumin. Kanë hyrë në një ambjent që përdorej si zyrë. Pasi kanë bërë përpjekje për të nxjerrë nga muri kasafortën dhe nuk kanë mundur, kanë dalë nga objekti.

- Me datë **23.10.2009** të pandehurit *S. K , E. L , S. B , T. M dhe D. D* në bashkëpunim mes tyre kanë vjedhur ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar të Danimarkës në Tiranë, rruga “Dëshmorët e 4-Shkurtit”. Konkretisht rreth orës xx.xx të mëngjezit ata janë futur në këto zyra nëpërmjet taracës së një pallati ngjitur me të duke vendosur shkallë për të komunikuar. Pasi kanë hyrë në ambjentet e brendshme kanë vjedhur një sasi prej **1000 Euro, dy kompjuter Laptop dhe sende të tjera.** Po atë ditë të pandehurit *S. B , S. K dhe D. D* kanë shkuar në qytetin e Korçës ku kanë takuar deklaruesit *M. Xh* , me qëllim shitjen e sendeve të vjedhura. Sipas rezultatit të përgjimit rezulton se shtetasit *E. L , S. K dhe T. M* kanë hyrë në ambjentet e brendshme të ambasadës ndërsa të pandehurit *S. B dhe D. D* kanë ruajtur dhe kanë ndihmuar në transportimin e autorëve dhe sendeve të vjedhura.

- Me datë **06.12.2009**, të pandehurit *S. K , E. L , D. D* dhe një person tjetër i paidentifikuar kanë tentuar të vjedhin në ambjentet e brendshme të shoqërisë “xxxxxx xxxxxxxx” sh.p.k. që ndodhet në hyrje të autostradës Tirane Durres. Ata kanë hyrë në ambjentet e rrethuara duke kaluar kangjellat. Kanë thyer dritaren prej duralumini duke hyrë në ambjentet e brendshme të kësaj shoqërie. Aty kanë tentuar të hapin kasafortën e shoqërisë

me kaçavidë dhe në pamundësi të hapjes së saj janë larguar. Kanë bërë përpjekje që ta shkulin nga muri ku ishte vendosur, por nuk kanë arritur pasi ishte e betonuar. Më pas janë larguar nga zyra dhe ambjentet e shoqërisë.

Veprimtaria kriminale e shtetasve të mësipërm është kryer në kuadrin e grupit të strukturuar kriminal. Të pandehurit **S. K**, **S. B** dhe **E. (F) L.**, kanë drejtuar grupin e strukturuar kriminal dhe në përbërje të tij ishin të pandehurit **A. B** dhe **D. D.** Shtetasit **E. H**, **T. M** dhe **D. M** i kanë kryer këto vepra penale të formën e bashkëpunimit të thjeshtë.

Nga hetimet e mësipërme ka rezultuar se të pandehurit **S. K**, **E. L**, **S. B**, **A. B**, **T. M**, **D. D**, **E. H** e **D. M** në bashkëpunim me njëri-tjetrin nga muaji shkurt 2009 e në vazhdim kanë kryer disa disa vjedhje me qëllim realizmin e përfitimeve materiale. Veprimtaria e tyre kriminale ka qënë e qëndrueshme, e shtrirë për një kohë të gjatë dhe në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë vjedhur 10 objekte të ndryshme të cituara më lart. Nga faktet kriminale konkludohet se drejtuesit e grupit kanë rekrutuar persona nga rrethi i të njohurve të tyre ose të afërm të personave që do të vidheshin dhe prisnin prej tyre të përfitonin informacion lidhur me sasinë e lekeve që ndodheshin në shoqëri ose shtëpi ose me pasjen ose jo të kasafortave. Gjithashtu prej tyre merrnin planimetrinë e objektit, mënyrën se si ruhej ose nëse kishte ose persona në shtëpi dhe kur ishte koha që nuk ishin në shtëpi. Karakteristikë e veprimeve të grupit është se pasi merr informacion të saktë për objektet që do vidhnin, për vendodhjen e kasafortave dhe vlerave monetare organizon punën për të kryer veprimin. Studionin me hollësi vendodhjen e objektit, mënyrën se si ruhej, me kamera, persona që e ruanin apo punonin etj. Në vijim merrnin masa për gjetjen e mjeteve për hapjen e objekteve dhe personave që do të kryejnë transportin e tyre dhe sendeve të vjedhura.

Të pandehurit **S. K**, **E. L**, **S. B** kanë krijuar, drejtuar dhe organizuar këtë Grup të Strukturuar Kriminal, pasi kanë qënë personat që përzgjidhnin objektet që do të vidheshin, përgatitinin mjetet e thyerjes dhe transportit, pjesëtarë e grupit që do të merrnin pjesë si dhe njëkohësisht merrnin pjesë vetë në kryerjen e vjedhjeve. Shtetasit nën hetim **A. B** dhe **D. D.** janë pjesëmarrës në këtë Grup të Strukturuar Kriminal pasi duke pasur dijeni të plotë për aktivitetin kriminal të grupit kanë kryer vëzhgimin dhe ruajtjejn e objekteve që do vidheshin, kanë sigurua mjete dhe kanë kryer transportin e autorëve dhe sendeve të vjedhura, si dhe kanë marrë pjesë dhe vetë aktivisht në realizimin e vjedhjeve.

Në përfundim të hetimeve (më datë 10/09/2010), procedimi penal nr.66 të vitit 2009, në ngarkim të të pandehurve **S. K.**, **S. B**, **E. L**, **A. B**, **D. D**, **T. M**, **E. H** dhe **D. M**, është dërguar për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të

Rënda Tirane , të cilët janë hetuar dhe gjykuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 134,139,333/a e 334 të Kodit Penal.

Në përfundim të gjykimit, me vendimin penal nr.31, datë 27/05/2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane, janë deklaruar fajtorë për veprat penale që dhe u akuzuan.

Më datë 17/06/2011, Prokuroria për Krime të Rënda, në bazë të akteve të procedimit penal nr.66 të vitit 2009, ka regjistruar procedimin pasuror nr.12.

Nga hetimi pasuror, i kryer rreth gjithë shtetasve të mësipërm, familjarëve, si dhe personave të lidhur me ta (sipas nenit 3/2 të ligjit nr.10192, datë 03/12/2009), aktualisht ka rezultuar se dispononin pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme si më poshtë :

- Shtetasi **S. K** , ka një llogari bankare në Bankën Kombëtare Tregtare ku ka vetëm një derdhje në dt 08.10.2008 shuma 3000 euro e cila është tërhequr në dt 17.10.2008. **Gjendja në këtë llogari është 0.00 euro.**
- Një llogari bankare me nr.xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx (numri i mëparshëm) në bankën Alpha Bank, si dhe numri aktual është **xxxxx xxxxx xxxx xxxx xxxx xxxxx, në shumën prej 15,129.67 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëzet e nëntë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) euro, në emër të shtetasës N. A , nëna e shtetasit S. K , e celur në datë 04.6.2009**, e cila është sekuestruar me procesverbalin e datës 24-12-2009.

Gjithashtu, nga hetimet e deritanishme na rezulton se llogaria e mësipërme pranë Alpha Bank, është krijuar më datë xx/xx/xxxx, pra **pas datës 22/02/2009**, në të cilën është provuar fillimi i aktivitetit kriminal i të pandehurit S. K .

Ky fakt, si dhe fakti që personat e lidhur me të pandehurin dhe familjarët e tij janë të lirë, përbën një rrezik real dhe potencial që pasuria e mësipërme të tjetërsohet, apo të humbasë (neni 11/1, pikat “a” dhe “b”). Ndaj dhe jemi të mendimit se llogaria bankare e mësipërme, në emër të personit të tretë N. A (nëna e të dënuarit S. K), duhet që t’i nënshtrohet procedurës së sekuestrimit, pasi ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme të bazuara në prova se kjo pasuri është krijuar **pas** periudhës së përfshirjes së të hetuarve në veprimtari kriminale (neni 3/4 të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009).

Prokurori pretendoi se i hetuari dhe familjarët e tij, nuk disponojnë të ardhura të ligjshme që të justifikojnë vlerën monetare të depozituar, por kjo pasuri është krijuar si rezultat i aktivitetit të paligjshëm të shtetasit S. K.

Gjykata vlerëson si të drejtë dhe të bazuar në ligj kërkesen e Prokurorisë për Krime të Rënda, e cila duhet të pranohet duke vendosur sekuestrimin e pasurive të shtetasit S. K dhe personit të tretë N. A sepse:

Shtetasi shqiptar S. K është hetuar dhe dënuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 134,139,333/a e 334 të Kodit Penal.

Pra nisur nga lloji i veprës për të cilën hetohet dhe ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm të bazuar tek indicjet se shtetasi S. K është i përfshirë në një veprimtari kriminale të vjedhjes së pasurisë në formën e grupit të strukturuar kriminal, ai është subjekt ndaj pasurive të të cilit zbatohen dispozitat e ligjit **nr. 10192, datë 03/12/2009** “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese Kundër Pasurisë”, sipas parashikimit të nenit 3/1 pika ç e këtij ligji.

Subjekt i këtij ligji është dhe shtetasja N. A (n.), sipas kuptimit të nenit 3/2 pikat a dhe b të ligjit **nr. 10192 datë 03/12/2009**.

Mbi këtë bazë, rezulton se akuza ka rregjistruar edhe procedimin pasuror nr. 12 në datën 17/06/2011, ndaj këtij shtetasi dhe pasi është kryer hetimi pasuror kjo çështje është paraqitur para kësaj gjykate me kërkesën për sekuestrimin e pasurive që janë verifikuar nga akuza se janë në pronësi të shtetasit S. K dhe familjarëve të tij.

Ndonëse ligji nr.10192 ka datën 03/12/2009 dhe procedimi penal për shtetasin S. K ka filluar, në datën 29/09/2009 në bazë të nenit 3/4 të ligjit nr.10192, datë 03/12/2009, ky ligj ka fuqi prapavepruese ndaj pasurisë së vënë nga shtetasi S. K në periudhën e përfshirjes së tij në veprimtarinë kriminale për të cilën dyshohet.

Nga hetimi pasuror i kryer nga policia gjyqësore, sipas parashikimit të nenit 6 të ligjit nr.10192, akuza pretendon se si rrjedhojë e veprimtarisë kriminale, shtetasi S. K. ka fituar mjete financiare në mënyrë të paligjshme të cilat i ka depozituar në një llogari bankare, nëpërmjet nënës së tij në Alpha Bank, vlera e të ciles (15.129.67 euro), haptazi nuk përputhet me të ardhurat ekonomike të verifikuara nga akuza se ka siguruar i dënuari S. K dhe familjarët e tij.

Pra në bazë të provave të paraqitura nga akuza, gjykata vlerëson se shtetasi **S. K** është subjekt i ligjit nr. 10192 datë 03/12/2009 **“Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”** sepse jo vetëm që ka dyshime të arsyeshme të bazuar në indicje se ai ka kryer një nga veprat penale të

parashikuara në nenin 3 të ligjit nr.10192, por edhe sepse i janë evidentuar nën posedim familjarëve të tij vlera monetare, të cilat nuk justifikohen dukshëm me të ardhurat e tyre.

Gjykata mbi bazën e provave të shqyrtuara vlerëson se ekziston një rrezik real për humbjen e kësaj vlere monetare në shumën **15,129.67 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëzet e nëntë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) euro**, rrethanë, kjo e parashikuar nga neni 11/1 pika a e ligjit **nr. 10192, datë 03/12/2009**, prandaj me qëllim ruajtjen e saj, është e nevojshme vendosja e masës së sekuestrimit.

Meqënëse sipas nenit 12 të ligjit **nr. 10192, datë 03/12/2009**, ky gjykim u zhvillua vetëm me prezencën e prokurorit, urdhërohet sekretaria gjyqësore të njoftojë shtetasin S. K dhe personin e tretë N. A , në emër të së cilës rezultojnë vlerat montare që sekuestrohen sipas neneve 130 e vijues të K.Pr.Civile, në adresat e vendndodhjes së tyre.

Për ekzekutimin e këtij vendimi, ne perputhje me nenin 14 te ligjit **nr. 10192, datë 03/12/2009** urdhërohet Zyra e Permbarimit Gjyqësor Tirane, ndërsa për administrimin dhe përdorimin e llogarise bankare ngarkohet **z. G. L.**, i cili është administrator pranë Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tirane.

Mbi arsyetimin e pasqyruar më sipër në bazë të nenit 212 e vijues te K.Pr.Civile dhe neneve 3/1/d, 3/2/a, 3/4 11, 12, 14 dhe 15 e vijues të ligjit **nr. 10192, datë 03/12/2009** “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, kjo gjykatë pasi formoi bindjen dhe në mbështetje të provave të shqyrtuara në këtë gjykim:

V E N D O S I

Pranimin e kerkesës duke sekuestruar pasuritë e mëposhtme:

1. -Llogarinë bankare me nr. **xxxxxxxxxxxxxx**, e cila ndodhet pranë Alpha Bank, si dhe **numri aktual xxxx xxxx xxx xxx xxxx xxxxx, në shumën prej 15,129.67 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëzet e nëntë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) euro** në emër të shtetasës N. A (nëna e shtetasit S K), **e çelur më datë 04.06.2009.**
2. Për Administrimin dhe përdorimin e llogarisë bankare ngarkohet **z.G.**

L., i cili është administrator pranë Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

3. Për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Përmbartimit - Tiranë.
4. Urdhërohet sekretaria gjyqësore e kësaj gjykate të dërgojë menjëherë kopje të këtij vendimi në institucionet e mësipërme si dhe për njoftimin e zotëruesve të pasurive S. K.dhe N. A., në adresat e banimit, ose qëndrimit të tyre të tyre.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda brenda afatit ligjor.

U shpall sot në Tiranë, më datë 29/12/2011, ora 11.00.

Sekretar

Besjan HYSI

Gjyqtare

Iliriana OLLDASHI

